



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucion i Avokatit të Popullit  
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br.No. 688/2019  
Nr.i fqj/Br.str./Nr.pg.  
Data/Datum/Date: 23/04/19

PRIŠTINË-PRIŠTINA-PRISTINA



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME  
I  
MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS  
LIDHUR ME VIZITËN NË  
QENDRËN E MBAJTJES PËR TË HUAJT NË VRANIDOLL

Për: **Z. Ekrem Msutafa, Ministër**  
Ministria e Punëve të Brendshme

Kopje: **Duda Balje, Kryetare**  
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të  
Pagjetur dhe Petacione

**Z. Valon Krasniqi, Drejtor**  
Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion

**Z. Selman Nimanaj, Drejtor**  
Qendra e Mbajtjes për të Huaj

Prishtinë, më 23 prill 2019

## **HYRJE**

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit (MKPT) e ka vizituar Qendrën e Mbajtjes për të Huajt në Vranidoll.

MKPT-ja, bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë këtu edhe vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, qëndrimi i të cilëve në Republikën e Kosovës bie ndesh me ligjet në fuqi dhe të cilët janë subjekt i kthimit me forcë nga Republika e Kosovës.

Bazuar në këtë mandat, MKPT-ja, më 13 shkurt 2019, e ka vizituar Qendrën e Mbajtjes për të Huajt (në tekstin e mëtejmë “QMH”). QMH-ja funksionin në kuadër të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DShAM) i Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Sipas nenit 2 të Rregullores (MPB) nr. 04/2018 për Funksionimin e Qendrës për Mbajtjen e të Huajve (në tekstin e mëtejmë “Rregullorja”), në këtë qendër vendosen të huajt të cilët janë subjekt i largimit me forcë, si dhe të huajt për të cilët konsiderohet se e cenojnë sigurinë publike, me qëllim të vërtetimit të identitetit të tyre dhe për arsyet tjera.

### **Qëllimi i vizitës**

Qëllimi i kësaj vizite ishte monitorimi i respektimit të të drejtave për të huajt, të cilët mbahen në QMH, të cilat parashihen me Ligjin për të Huajt, me Ligjin për Azil, me Rreguloren nr. 04/2018 për Funksionimin e Qendrës së Mbajtjes për të Huajt, me standartet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si dhe zbatimi i rekomandimeve të MKPT-së dërguar autoriteteve kompetente përmes raportit me rekomandime, i publikuar më 2 maj 2018.<sup>1</sup>

Po ashtu, gjatë vizitës u trajtua çështja e procedurave të pranimit, njohja e të huajve me të drejtat e tyre, trajtimi dhe akomodimi, kujdesi shëndetësor i cili u ofrohet, kontaktet e mirëfillta me botën e jashtme, personeli i QMH-së dhe personeli i sigurisë, trajnimet dhe përgatitja adekuate e tyre për të punuar me këtë kategori, masat disiplinore të cilat mund t'u shqiptohen të huajve në QMH dhe mënyra e ekzekutimit të tyre, e drejta për të ankimore masën e tillë dhe aspekte të tjera.

### **Përbërja e ekipit monitorues**

1. Ekipi monitorues përbëhet nga udhëheqësja e MKPT-së, një këshilltar ligjor për parandalim të torturës, një psikologe-këshilltare, një mjeke-këshilltare, një këshilltar-punëtor social, dy ekspertë të Këshillit të Evropës (në cilësi të vëzhguesve).

### **Bashkëpunimi i personelit të QMH me MKPT gjatë vizitës**

2. Gjatë vizitës në QMH, personeli i Qendrës i ofroi MKPT-së bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha hapësirat e Qendrës. Ekipit iu siguruan të gjitha

<sup>1</sup> Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën për Mbajtjen e të Huajve, publikuar më 2 maj 2018. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/02/22/raport-me-rekomandime-vizite-ne-qendren-e-mbajtjes-per-te-huajt-ne-vranidoll/>.

informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe iu mundësua intervistimi i personave që gjendeshin në mbajtje, pa prezencë të zyrtarëve të sigurimit dhe zyrtarëve tjerë të QMH-së.

### Paraburgimi i të huajve si masë e fundit

- Në pikëpamje të standardeve ndërkontaktore për të drejtat e njeriut, paraburgimi (dërgimi i të huajti në mbajtje) duhet të jetë masa e fundit të cilën e zbatojnë autoritetet e një shteti për ta larguar të huajin nga territori, i cili është subjekt i kthimit me forcë. MKPT-ja vëren se Ligji 04/L-219 për të Huajt i Republikës së Kosovës parasheh se masat tjera alternative kanë përparësi në raport me dërgimin e të huajit në mbajtje.<sup>2</sup> Po ashtu, Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejmë “KPT”), në standardet e përcaktuara në vitin 2017, përcakton se paraburgimi i të huajit sipas ligjit për të huajt duhet të jetë masë e fundit dhe se masave të tjera alternative duhet t'u jepet epërsi.<sup>3</sup>

### Garancitë procedurale gjatë paraburgimit

- Neni 8 i Rregullores përcakton se pranimi në Qendër bëhet bazuar në urdhrin për ndalimin e të huajit në Qendër, i cili nxirret nga Drejtoria për Migrim dhe të Huajt (DMH). Me rastin e dorëzimit të të huajit në Qendër, DMH-ja duhet të dorëzojë: urdhrin për ndalim në Qendër, urdhrin për largim me forcë, si dhe urdhrin për largim vullnetar nëse është nxjerrë, raportin e zyrtarit policor, duke përfshirë edhe vlerësimin e rrezikshmërisë, vërtetimin për dokumentet dhe gjësendet e sekuestruara, si dhe dokumentet dhe gjësendet e sekuestruara. Më tej, sipas Rregullores, Qendra e konfirmon pranimin e të huajit në Qendër përmes fletëpranimit<sup>4</sup>. Bazuar në dosjet e të huajve prezent, MKPT-ja ka vërejtur se nga autoritetet janë respektuar kriteret e lartpërmendura të përcaktuara në Rregullore.
- MKPT-ja vëren se standardet e përcaktuara nga KPT-ja përcaktojnë shprehimisht se të gjithë të huajt e paraburgosur si emigrantë të parregullt, që nga momenti i privimit nga liria, duhet t'i gëzojnë tri të drejta themelore në të njëjtën mënyrë siç i gëzojnë edhe kategoritë tjera të personave të privuar nga liria. Këto të drejta janë: *të kenë qasje tek avokati mbrojtës, të kenë qasje tek mjeku dhe të kenë mundësinë të njoftojnë të afërmitt e tyre apo palën e tretë sipas përzgjedhjes së tyre, përfaktin se janë paraburgosur.*<sup>5</sup>
- Po ashtu, MKPT-ja vëren se KPT-ja, në raportin për vizitën në Holandë në vitin 2007, në paragrafin 36, shprehimisht përcakton:

*“Sipas pikëpamjes së Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, të huajt e paraburgosur për shkak të emigracionit (qofshin ata azilkërkues ose jo) duhet të kenë të drejtën që nga momenti i privimit të tyre nga liria, të informojnë personin sipas përzgjedhjes së tyre për situatën e tyre, të kenë qasje tek mjeku dhe avokati. Më tej, të*

<sup>2</sup> Ligji nr. 04/L-219 për të Huajt, nen 97, paragrafi 2.

<sup>3</sup> KPT, Standardet e publikuara në mars të vitit 2017 për paraburgimin e të huajve. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>.

<sup>4</sup> Neni 8, paragrafi 3 i Rregullores.

<sup>5</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 19-të i Përgjithshëm i Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, paragrafi 81, në: [http://hudoc.cpt.coe.int/eng/#%22CPTSectionID%22:\[%22p-standards-inf-2009-27-part-en-3%22\]](http://hudoc.cpt.coe.int/eng/#%22CPTSectionID%22:[%22p-standards-inf-2009-27-part-en-3%22]).

*huajt e paraburgosur për shkak të imigracionit, duhet të njoftohen shprehimisht pa vonesa dhe në një gjuhë të cilën ata e kuptojnë, për të drejtat e tyre dhe procedurën, e cila zbatohet në rastin e tyre. Për këtë qëllim, të paraburgosurve për shkak të imigracionit, duhet në mënyrë sistematike t'u ofrohet dokumenti, i cili përmban këtë informacion; dokumenti duhet të jetë në dispozicion në gjuhët më të shpeshta të folura nga personat në fjalë dhe nëse është e domosdoshme, duhet të janë në dispozicion shërbimet e përkthyesit. Personat në fjalë (të paraburgosurit) duhet të vërtetojnë se ata janë njoftuar për të drejtat e tyre, në gjuhën të cilën ata mund ta kuptojnë.”<sup>6</sup>*

7. Bazuar në dispozitat e Ligjit 04/L-219 për të Huajt në Republikën e Kosovës, i huaji i cili vendoset në QMH njoftohet në formë të shkruar, në njëren nga gjuhët zyrtare dhe në gjuhën angleze, për ndalimin në Qendrën e Mbajtjes, i cili përmban arsyen e ndalimit, afatet e ndalimit, të drejtën të sigurojë mbrojtjen ligjore të tij, si dhe të kontaktøjë me të afërmit e vet.<sup>7</sup>
8. Sa i përket së drejtës së të huajit për të kontaktuar konsullatën apo ambasadën e shtetit, MKPT-ja vëren se Ligji për të Huajt përcakton të drejtën e të huajit për të njoftuar përfaqësuesin diplomatik apo konsullor, lidhur me ndalimin e tij.<sup>8</sup> Po ashtu, KPT-ja, në Raportin e 19-të Përgjithshëm, të drejtën e të paraburgosurit të huaj për të kontaktuar konsullatën e vendit nga i cili janë e konsideron si një të drejtë themelore.<sup>9</sup>
9. Sipas Rregullores, i huaji i vendosur në këtë Qendër ka të drejtat në vijim: informimi lidhur me të drejtën e ankimit për ndalimin në Qendër, të drejtën lidhur me ndihmën juridike falas, të drejtën për përkthyesin në gjuhën e tij ose në një gjuhën të cilën ai/ajo e kuption, të drejtën për të komunikuar me organet dhe organizatat relevante vendore apo ndërkombëtare, si dhe me organizatat joqeveritare.<sup>10</sup>
10. Lidhur me të drejtat e të huajve të paraburgosur, në Raportin me rekomandime, i publikuar më 2 maj 2018, MKPT-ja u ka rekomanduar autoriteteve kompetente: “Për të gjitha të drejtat dhe obligimet e tyre, të huajt të njoftohen përmes një dokumenti të veçantë, në gjuhën të cilën e kuptojnë dhe në të cilin ata vërtetojnë se i kanë kuptuar të drejtat dhe obligimet e tyre.” Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se autoritetet kompetente ende nuk e kanë zbatuar këtë rekomandim.
11. MKPT-ja ka vërejtur se të gjitha korridoret e QMH-së mbulohen nga kamerat e sigurisë, të cilat janë garanci shtesë kundër keqtrajtimit fizik, si dhe mbrojtje për personelin nga akuzat e rrejshme. Megjithatë, gjatë vizitës në QMH, më 26 shkurt 2019, MKPT-ja u njoftua se jo të gjitha kamerat e sigurisë janë në funksion. Në raportin për vizitën në

<sup>6</sup> Shih në: [http://hudoc.cpt.coe.int/eng#%22CPTSectionID%22:\[%22p-nld-20070607-en-14%22\]](http://hudoc.cpt.coe.int/eng#%22CPTSectionID%22:[%22p-nld-20070607-en-14%22]).

<sup>7</sup> Ligji 04/L-219 për të Huajt, neni 108.

<sup>8</sup> Ligji 04/L-219 për të Huajt, neni 114, paragrafi 3.

<sup>9</sup> Për më shumë shih në: [http://hudoc.cpt.coe.int/eng#%22CPTSectionID%22:\[%22p-standards-inf-2009-27-part-en-3%22\]](http://hudoc.cpt.coe.int/eng#%22CPTSectionID%22:[%22p-standards-inf-2009-27-part-en-3%22]).

<sup>10</sup> Neni 11 i Rregullores, Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>.

Irlandë në vitin 2010, KPT-ja konsideroi ekzistimin e kamerave të sigurisë si një nga garancitë kundër keqtrajtimit fizik në qendrat ku mbahen personat e privuar nga liria.<sup>11</sup>

12. Sa i përket së drejtës për t'u informuar në gjuhën e tyre apo në gjuhën të cilën të huajt e paraburgosur e kuptojnë dhe së drejtës për të pasur shërbime të një përkthyesi, MKPT-ja u njoftua nga QMH-ja se MPB-ja posedon listën e përkthyesve të cilët ofrojnë shërbime përkthimi edhe në gjuhët tjera të të huajve, përveç shërbimeve të përkthimit në gjuhën angleze.
13. MKPT-ja, gjatë vizitës, ka vërejtur se të huajt në QMH informohen për të drejtat e tyre, përmes broshurave të shkruara në gjuhët më të shpeshta dhe në gjuhën arabe.

### **Keqtrajtimi**

14. Gjatë vizitës së MKPT-së në Qendër ishin prezent dy persona të huaj të ndaluar. MKPT-ja ka kontrolluar dosjet e tyre dhe ka realizuar intervista në dhomat ku ishin të akomoduar, pa prezencë të zyrtarëve të QMH-së dhe të personelit të sigurimit. MKPT-ja nuk ka pranuar asnjë ankesë nga personat e intervistuar për keqtrajtim fizik, përdorim të tepruar të forcës fizike apo sjellje nga zyrtarët e sigurisë dhe zyrtarët e QMH, e cila nuk do të ishte në pajtim me respektimin e dinjitetit të tyre.

### **Incidenti i datës 7 dhjetor 2018**

15. Gjatë kontrollit të regjistrave dhe dosjeve të personave të akomoduar në këtë qendër, MKPT-ja ka vërejtur se, më 7 dhjetor 2018, njëri nga personat e huaj të ndaluar, ka shkelur rregullat e QMH-së, duke shfaqur sjellje problematike, me ç' rast i është shqiptuar masa disiplinore: heqja e së drejtës për aktivitetet të lirë, për rekreacion, për tv, për internet, për aktivitete sportive apo kulturore, në kohëzgjatje deri në pesë ditë. MKPT-ja intervistoi personin në fjalë dhe nuk pranoi ankesa lidhur me trajtimin e tij nga ana e personelit të QMH-së dhe personelit të sigurisë.

### **Ndihma juridike falas**

16. Sipas nenit 29 të Rregullores, të huajit i ofrohet këshillimi, përfaqësimi juridik dhe kur është e nevojshme edhe ndihma gjyqësore. Kjo e drejtë mund të ofrohet falas me kërkësë të të huajit. I huaji ka të drejtë të kontaktojë ndonjë OJQ, Agjencinë për Ndihmë Juridike, të cilat i ofrojnë ndihmë juridike falas.
17. Gjatë vizitës *ad-hoc* në QMH, më 26 mars 2019, MKPT-ja u njoftua se DShAM-i dhe Agjencia për Ndihmë Juridike Falas janë në bisedime për nënshkrim të një memorandum bashkëpunimi dhe, në këtë mënyrë, të huajve në QMH do t'u ofrohen shërbime juridike falas. Një gjë e tillë u konfirmua edhe nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas dhe DShAM-i.

<sup>11</sup> Raporti i KPT-së për vizitën në Irlandë në vitin 2010, paragrafi 18, publikuar në vitin 2011, në:  
<https://rm.coe.int/1680696c98>.

## Kushtet materiale

18. Gjatë vizitës në Qendër, MKPT-ja ka vizituar dy objektet ku mbahen të huajt, përfshirë të gjitha hapësirat, siç janë: dhomat e interviewimit, dhomat e izolimit, dhomat e fjetjes, dhomat familjare, dhomat e aktiviteteve për të rritur, të cila ishin të pajisura me tv, letra, tabelë shahu, si dhe në një kënd ishte biblioteka me një numër të vogël të librave, dhoma e aktiviteteve për fëmijë e pajisur me lodra dhe e dizajnuar sipas standardeve, dhomën ku u mundësohej kryerja e aktiviteteve fetare, kuzhinën e cila ishte e kompletuar me orendi, si dhe një lavanteri e pajisur mjaftueshmë për kapacitetin e Qendrës. Të gjitha dhomat ofronin akomodim të denjë, ngrohje, ndriçim të mjaftueshmë natyral dhe artificial, si dhe dushe të cilat ishin në gjendje shumë të mirë. Të huajt në QMH mund të kenë qasje në dushe sa herë që ata duan. MKPT-ja konsideron se kushtet e akomodimit të QMH janë në nivel shumë të mirë.

## Ushqimi

19. Të gjithë të huajve u sigurohen tri shujta ditore. Shujtat ditore përbajnë 2000 kalori dhe sasi të mjaftueshme.<sup>12</sup> Rregullorja parasheh që të huajve në QMH u shërbehet ushqimi i posaçëm për shkaqe shëndetësore dhe për nevoja të veçanta. Po ashtu, sipas Rregullores, të huajve u shërbehet edhe ushqim sipas rekomandimit të mjekut. Fëmijët duhet të marrin ushqim të përshtatshëm për zhvillim. Nëse feja e të huajit parashikon rregulla lidhur me ushqimin, udhëheqësi i Qendrës e garanton respektimin e tyre.<sup>13</sup> Sipas drejtorisë, MPB-ja ka kontraktuar një kompani, e cila e furnizon QMH-në me ushqim.

## Regjimi

20. Neni 24, paragrafi 1, i Rregullores përcakton se çdo i huaj i ndaluar në Qendër ka të drejtë për ajrosje së paku dy orë në ditë në mjediset e jashtme të Qendrës. Për arsy shëndetësore, udhëheqësi i Qendrës mund ta zgjasë kohën e ajrimit.
21. KPT-ja, në standardet e përcaktuara në mars të vitit 2017 për paraburgimin e të huajve për shkak të imigracionit, thekson rëndësinë e një regjimi, i cili përmban sa më shumë aktivitete. Sipas KPT-së, sa më e gjatë që është periudha e mbajtjes së të huajve, po aq duhet të zhvillohen aktivitetet të cilat u ofrohen atyre.
22. MKPT-ja ka vërejtur se QMH-ja tani ka një fushë të vogël sportive, e cila është e pajisur me elementet përcjellëse, ku të huajt mund të luajnë futboll dhe basketboll. Përmes raportit për vizitën në QMH në vitin 2016, i cili u publikua në vitin 2017, MKPT-ja inkurajoj autoritetet kompetente që t'i shtojnë përpjekjet e tyre për t'i ofruar mundësitë për aktivitete konkrete sportive për të huajt në këtë qendër. MKPT-ja përshëndet hapat e ndërmarrë nga autoritetet kompetente për të krijuar kushte për ofrim të aktiviteteve konkrete sportive dhe aktiviteteve të tjera për të huajt në QMH.

<sup>12</sup> Neni 36 i Rregullores.

<sup>13</sup> Neni 36 i Rregullores.

23. Sipas drejtorisë, QMH-ja planifikon përshtatjen e dy dhomave në të cilat do të vendosen pajisje për lojëra, të cilat do të rrisin në këtë mënyrë aktivitetet rekreative-sportive për të huajt në mbajtje.

### Personeli i Qendrës për Mbajtjen e të Huajve

24. Personeli i QMH-së përbëhet nga udhëheqësi dhe një zyrtare. Gjatë vizitës, MKPT-ja u informua se personeli i sigurimit është i trajnuar për të kryer detyra të mbrojtës fizike të objektit dhe të pronës, por nuk janë të trajnuar për të punuar me persona të huaj të privuar nga liria, të cilët, sipas Ligjit për të Huajt, janë subjekt i kthimit me forcë. Standardet e KPT-së përcaktojnë se personeli i sigurisë në qendrat e mbajtjes për të huajt duhet të përzgjidhet me kujdes dhe të ketë trajnime të duhura.<sup>14</sup>

25. Më tej, KPT-ja përcakton se, krahas zotërimit të cilësive të zhvilluara në fushën e komunikimit ndër-personal, personeli i Qendrës duhet të familjarizohet me kulturat e ndryshme të të ndaluarve, të paktën disa prej tyre t'i kenë aftësitë gjuhësore përkatëse. Më tej, KPT-ja thekson se ata duhet t'i dallojnë simptomat e mundshme të reagimit ndaj stresit, që shfaqen nga personat e ndaluar dhe t'i marrin masat e përshtatshme.

26. Po ashtu, KPT-ja thekson se karakteri i një institucioni të paraburgimit për të huajt për shkak të imigrimit nuk duhet të jetë i tipit të burgut, që do të thotë se personeli i cili punon në qendrën e mbajtjes për të huajt nuk duhet të jetë i pajisur me shufra gome, pranga apo *pepper spray* dhe ka rekomanduar që pajisjet e tillë të mos barten në atë mënyrë që të shihen haptazi nga të huajt.<sup>15</sup>

27. Sipas zyrtarëve të QMH-së, personeli i sigurisë në QMH, në kuadër të pajisjeve të tyre, kanë pranga dhe shufra gome. Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se personeli i sigurisë i bartë pajisjet, të cilat i ka në dispozicion, në atë mënyrë që ato nuk mund të shihen haptazi nga të huajt e paraburgosur.

### Përdorimi i forcës fizike nga shërbimi i sigurimit

28. Sipas Rregullores, shërbimi i sigurimit mund ta përdorë forcën vetëm si mjet të fundit, nëse kjo është e nevojshme për vetëmbrojtje, për mbrojtjen dhe sigurinë e të huajit ose për mbrojtjen e rendit të përgjithshëm dhe të sigurisë brenda Qendrës. Përdorimi i forcës duhet të jetë i ligjshëm, proporcional dhe i arsyeshëm për qëllimet e nevojshme.<sup>16</sup> Po ashtu, Rregullorja përcakton se çdo rast i përdorimit të forcës fizike duhet t'i raportohet udhëheqësit të Qendrës.<sup>17</sup>

### Kujdesi shëndetësor

29. Sa u përket shërbimeve shëndetësore, Ligji 04/L-219 për të Huajt përcakton se Qendra e Mbajtjes duhet t'i plotësojë të gjitha kushtet e një trajtimi njerëzor si dhe respektimin e të

<sup>14</sup> Standardet e KPT-së për paraburgimin e të huajve, publikuar në vitin 2017, shih në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>.

<sup>15</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, të ndaluarit për shkak të imigracionit, standardet e publikuara në vitin 2017, në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>.

<sup>16</sup> Neni 21, paragrafi 1, i Rregullores.

<sup>17</sup> Neni 21, paragrafi, 2 i Rregullores.

drejtave njerëzore, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe të mundësojë ofrimin e shërbimeve shëndetësore.<sup>18</sup>

30. Më tej, Rregullorja përcakton se i huaji, gjatë qëndrimit në QMH, ka të drejtë për shërbime mjekësore. Sipas Rregullores, personeli mjekësor kryen ekzaminimin e përgjithshëm mjekësor të të huajit, i cili ndalohet në Qendrën për Mbajtjen e të Huajve.<sup>19</sup>
31. Të huajve që mbahen në QMH, shërbimet mjekësore u jepen nga Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF) më e afërt dhe, sipas nevojës, dërgohen për shërbime spitalore regionale dytësore apo edhe në Qendrën Klinike Universitare (QKUK), ku u ofrohen edhe shërbimet shëndetësore terciare, pasi që QMH-ja ende nuk ka personel mjekësor, edhe pse MKPT-ja, përmes Raportit me rekomandime, i publikuar më 2 maj 2018, rekomandoi që QMH-ja të ketë në dispozicion së paku një infermiere. MKPT-ja ka vërejtur se hapësirat për shërbime shëndetësore janë të përgatitura dhe i plotësojnë kushtet sa i përket hapësirës, por nuk kanë inventar të domosdoshëm shëndetësor (aparatura, medikamente, material shpenzues etj.).
32. Sa u përket shërbimeve psikologjike, të cilat parashihen me nenin 41 të Rregullores, MKPT-ja ka vërejtur se ato ofrohen nga psikologu i kontraktuar nga Shërbimi Jezuit për Refugjatë.

### Rëndësia e kontolleve mjekësore fillestare

33. Lidhur me rëndësinë e kontolleve fillestare mjekësore, KPT-ja përcakton: “*Së paku një person me kualifikim të infermierit duhet të jetë i pranishëm në baza ditore në të gjitha qendrat për imigrantët e parregulltë. Një person i tillë do të duhej që të kryente skrinimin fillestar mjekësor të të sapo pranuarve (në veçanti për sëmundje të transmetueshme, përfshirë tuberkulozin), të pranojë kërkesat për t'u kontrolluar tek mjeku, të garantojë sigurimin dhe distribuimin e medikamenteve, të mbajë dokumentacionin mjekësor dhe t'i mbikëqyrë kushtet e përgjithshme higjienike.*”<sup>20</sup>
34. MKPT-ja konsideron se marrja e anamnezës, respektivisht shënimëve shëndetësore për jetën dhe gjendjen momentale shëndetësore, janë shumë të rëndësime në identifikimin jo vetëm të sëmundjeve të transmetueshme apo lëndimeve, por edhe të personave që kanë probleme me shëndetin mendor, të personave abuzues të substancave dhe që janë me rrezikshmëri për vetëlëndime dhe tentim-vetëvrasje. Kështu që, me marrjen e anamnezës së mirëfilltë bëhet parandalimi i dukurive në të ardhmen.
35. Rregullorja përcakton se, pas vendosjes së të huajit në Qendër, në afat brenda 24 orëve, i huaji dërgohet për ekzaminim mjekësor në QKUK (apo në ndonjë institucion tjetër shëndetësor), nën përcjellje nga Policia (DMH-së).

<sup>18</sup> Ligji 04/L-219 për të Huajt, neni 107, paragrafi 2.

<sup>19</sup> Neni 13 i Rregullores.

<sup>20</sup> Ibid.

## Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore në QMH

36. Rregullorja parasheh se të gjitha konstatimet mjekësore duhet të ruhen në dosjen e të huajit dhe në Sistemin për Menaxhimin e të Dhënave. Kartela mjekësore mbahet në mënyrë konfidenciale dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
37. KPT-ja, në standardet e përcaktuara për paraburgimin për shkak të imigrimit, përcakton: *“Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore duhet të respektohet njësojë si në komunitet dhe në veçanti dosjet mjekësore të imigrantëve të parregullt, nuk duhet të jenë të qasshme për personelin jo mjekësor, përkundrazi, ato duhet të mbahen të myllura nga infermierja apo mjeku. Për më shumë, të gjitha ekzaminimet mjekësore duhet të kryhen në atë mënyrë, që të mos shihen dhe dëgjojen nga personeli i sigurisë, përveç në rast se mjeku kërkon ndryshe në raste të veçanta.”<sup>21</sup>*
38. Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se në QMH terapia e caktuar nga mjeku shpërndahet nga stafi prezent, e jo nga profesionistët shëndetësorë, dhe ndodh që edhe trajtimi i ndonjë plage të bëhet nga stafi, i cili nuk ka asnjë trajnim për ofrim të shërbimeve shëndetësore primare. Po ashtu, MKPT-ja ka vërejtur se raportet shëndetësore mbahen së bashku me dosjen e përgjithshme të të huajit (është e hapur për t'u parë) dhe nuk ka konfidencialitet. Dosja mbahet në formë elektronike dhe fizike.
39. Po ashtu, MKPT-ja konstaton se nuk është zbatuar rekomandimi: “QMH-ja duhet të mbajë protokollet si në vijim: Protokolle për vetminë, për lëndime trupore, vetëlëndime, tentim-vetëvrasjes, abuzim seksual dhe të vdekjeve.”

## Masat disiplinore

40. Sipas Rregullores, masat disiplinore të cilat mund t'i shqiptohen të huajt janë: vërejtja me gojë apo me shkrim, detyrimi për mirëmbajtjen dhe pastrimin e Qendrës, heqja e së drejtës për aktivitete të lira, për rekreacion, për tv, për internet, heqja e së drejtës për aktivitete kulturore dhe sportive në kohëzgjatje deri në 5 ditë dhe izolimi deri në 48 orë.<sup>22</sup>
41. Gjatë kontrollit të regjistrave dhe dosjeve të personave të akomoduar në këtë qendër, MKPT-ja ka vërejtur se, më 7 dhjetor 2018, njëri nga personat e huaj të ndaluar i ka shkelur rregullat e Qendrës, duke shfaqur sjellje problematike në Qendër, me ç' rast i është shqiptuar masa disiplinore *heqja e së drejtës për aktivitet të lirë, për rekreacion, për tv, për internet, për aktivitete sportive apo kulturor, në kohëzgjatje deri në pesë ditë*.
42. MKPT-ja vëren se Rregullorja e tanishme, për dallim nga Rregullorja e mëparshme, parasheh se vendimi për shqiptimin e masës disiplinore duhet t'i dorëzohet edhe të huajit, të cilit i shqiptohet masa.<sup>23</sup> MKPT-ja, gjatë vizitës, nuk ka vërejtur dëshmi se të huajit, të cilit i është shqiptuar masa disiplinore e izolimit, i është dorëzuar kopja e vendimit. Bazuar në këtë, MKPT-ja, gjatë vizitës, i ka rekomanduar udhëheqësit të QMH-së që të

<sup>21</sup> Shih në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>.

<sup>22</sup> Neni 44 i Rregullores.

<sup>23</sup> Neni 44, paragrafi 3, i Rregullores.

regjistrohet fakti i dorëzimit të kopjes së vendimit për masë disiplinore të huajit në mbajtje.

43. Në Raportin me rekomandime, i publikuar më 2 maj 2018, MKPT-ja u ka rekomanduar autoriteteve kompetente: “*Rregullorja të përbajë një dispozitë të veçantë, e cila parasheh se të huajit, të cilat i shqiptohet masa disiplinore, t'i dorëzohet një kopje e vendimit, në gjuhën të cilin ai/ajo e kupton.*” Prandaj, MKPT-ja, përmes Raportit me rekomandime, përshëndet zbatimin e këtij rekomandimi nga autoritetet kompetente.
44. Standardet e KPT-së përcaktojnë se qendrat e mbajtjes për të huajt duhet të kenë rregullore formale disiplinore. Këto rregullore duhet t'u sigurojnë të paraburgosurve të drejtën për t'u dëgjuar lidhur me veprën për të cilën pohohet se ata e kanë kryer dhe për t'iu ankuar autoritetit më të lartë kundër çdo mase të shqiptuar. Më tej, standardet e KPT-së përcaktojnë se duhet të miratohen procedura të qarta disiplinore, të cilat ua mundësojnë personave të paraburgosur të drejtën që të informohen me shkrim lidhur me akuzat kundër tyre dhe të kenë mundësinë të thërrasin dëshmitarë në favor të tyre.<sup>24</sup>

#### **Masa disiplinore e izolimit deri në 48 orë**

45. MKPT-ja vëren se Rregullorja parasheh shqiptimin e masës së izolimit deri në 48 orë ndaj të huajit në mbajtje, në rast të shkeljes së paraparë me Rregullore.<sup>25</sup> Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se QMH-ja nuk ka regjistër të ndarë, në të cilin regjistrohen informata të plota, siç janë: data e futjes dhe daljes nga izolimi, baza e shqiptimit të masës së tillë etj. KPT-ja, në standardet e përcaktuara për të huajt në paraburgim, thekson rëndësinë e një regjistri të tillë.<sup>26</sup> MKPT-ja ka vërejtur se këto të dhëna regjistrohen vetëm në vendimin e udhëheqësit të QMH-së, me të cilin të huajit i shqiptohet masa disiplinore.
46. Në raportin për vizitën në Ukrainë në vitin 2009, KPT-ja u kishte rekomanduar autoriteteve ukrainase që të huajit, të cilat i shqiptohet masa disiplinore e veçimit, t'ia dorëzojnë një kopje të vendimit relevant dhe ta informojnë për mundësinë për ta apeluar vendimin në fjalë tek një autoritet i jashtëm, t'u garantojnë të huajve qasje të rregullt në dush dhe që të rishqyrtojnë regjimin e ofruar për të huajt, të cilëve u shqiptohet kjo masë disiplinore.
47. Sipas KPT-së, në veçanti duhet të ndërmerren hapa për të siguruar se ata kanë qasje në oborrin i cili është i pajisur në mënyrë adekuate për ajrosje, së paku një orë në ditë, dhe të kenë qasje në materiale për lexim dhe për dush.<sup>27</sup>
48. MKPT-ja vëren se Rregullorja nuk parasheh të drejtën e të huajit në izolim për të dalë në ajrosje në ambiente të jashtme në QMH. Lidhur me këtë, MKPT-ja i rekomandoi menjëherë QMH-së që, në pajtim me standardet e lartpërmendura, t'ua mundësojë të

<sup>24</sup> Standardet e KPT-së, publikuar në vitin 2017, paraburgimi i të huajve, pika 7, shih në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>.

<sup>25</sup> Neni 44, paragrafi 2.24, i Rregullores.

<sup>26</sup> Standardet e KPT-së, shih në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>.

<sup>27</sup> Vizita e KPT-së në Ukrainë, 2009, paragrafi 71. Për më shumë shih në:

[https://hudoc.cpt.coe.int/eng#%22sort%22:\[%22CPTDocumentDate%20Descending,CPTDocumentID%20Ascending,CPTSectionNumber%20Ascending%22\],%22CPTSectionID%22:\[%22p-ukr-20090909-en-17%22\]}](https://hudoc.cpt.coe.int/eng#%22sort%22:[%22CPTDocumentDate%20Descending,CPTDocumentID%20Ascending,CPTSectionNumber%20Ascending%22],%22CPTSectionID%22:[%22p-ukr-20090909-en-17%22]}).

huajve, të cilëve u shqiptohet masa disiplinore e izolimit, ta gjëzojnë të drejtën në ajrosje, të kenë të drejtë të bëjnë dush dhe të kenë qasje në materiale për lexim.

### Monitorimi dhe mekanizmat e ankimit

49. Sistemi efektiv i parashtrimit të ankesave është garancia themelore kundër keqtrajtimit në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria. MKPT-ja konsideron se personat e vendosur në këto qendra duhet të kenë mundësi për të parashtruar ankesë brenda QMH-së dhe, në mënyrë konfidenciale, t'u mundësohet qasja tek autoriteti i duhur.
50. Neni 19 i Rregullores përcakton se të huajt kanë të drejtë ankesë tek udhëheqësi i Qendrës, lidhur më kushtet e pranimit në QMH dhe sjelljet e personelit. Ankesa shqyrtohet nga DShAM-i. Më tej, Rregullorja përcakton se në Qendër vendoset kutia e ankesave, e cila administrohet nga QMH-ja. Sipas drejtorisë, të huajt, përmes broshurave në gjuhë të ndryshme, njoftohen menjëherë për të drejtën e tyre për të parashtruar ankesë.
51. Sa i përket monitorimit, përvèç MKPT-së, të huajt në Qendër mund të vizitojen në çdo kohë nga UNHCR-ja, IOM-i, Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, Komiteti i Organizatës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës. Rregullorja parasheh se udhëheqësi i Qendrës mund t'u japë të drejtë qasjeje në Qendër edhe institucioneve apo organizatatave tjera relevante.<sup>28</sup>

### Kontakti me botën e jashtme

52. Sipas standardeve të KPT-së, të ndaluarit e huaj duhet të kenë çdo mundësi për të qenë në kontakt të mirëfilltë me botën e jashtme (përfshirë mundësitë për të bërë telefonata dhe për të pranuar vizita) dhe liria e tyre e lëvizjes brenda qendrës së mbajtjes duhet të kufizohet sa më pak që të jetë e mundur.<sup>29</sup> Sipas nenit 25 të Rregullores, i huaji në mbajtje ka të drejtë të mbajë korrespondencë, të pranojë pako dhe sende të tjera. Po ashtu, të huajve në mbajtje u lejohet të pranojnë vizita.<sup>30</sup>
53. Rregullorja përcakton se i huaji ka të drejtë të bëjë telefonata sipas nevojës në kohëzgjatje prej 5 minutash, duke filluar nga ora 9:00 deri në orën 16:00, çdo ditë pune.<sup>31</sup> Sipas Rregullores, të huajve u mundësohen edhe thirrjet nga jashtë. Gjatë vizitës, MKPT-ja nuk ka pranuar ankesa sa i përket së drejtës për kontakte me botën e jashtme. Prandaj, bazuar në të gjeturat gjatë vizitës së realizuar, **MKPT-ja i rekomandon Ministrisë së Punëve të Brendshme:**
  - MKPT-ja ripërsërit rekomandimin se QMH-ja duhet të ketë në dispozicion së paku një infermiere, e cila do t'i kryente kontrolllet mjekësore të sapo pranuarve, do ta shpërndante terapinë dhe do të kujdesej për dosjet mjekësore të të huajve në QMH.
  - MKPT-ja ripërsërit rekomandimin se QMH-ja duhet t'i mbajë protokollet si në vijim: Protokolle për vetminë, për lëndime trupore, për vetëlëndime, për tentim-vetëvrasje, për abuzim seksual dhe të vdekjeve.

<sup>28</sup> Neni 27 i Rregullores.


<sup>29</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, shih në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>.

<sup>30</sup> Neni 27 i Rregullores.

<sup>31</sup> Neni 26 i Rregullores.

- MKPT-ja ripërsërit rekomandimin se personeli i sigurisë duhet t'u nënshtrohet trajnimeve adekuate për të punuar me këtë kategori.
- MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që, për të gjitha të drejtat dhe obligimet e tyre, të huajt të njoftohen përmes një dokumenti të veçantë, në gjuhën të cilën e kuptojnë dhe në të cilin ata vërtetojnë se i kanë kuptuar të drejtat dhe obligimet e tyre.
- Të huajve, të cilëve u shqiptohet masa disiplinore e izolimit, t'u mundësohet gjëzimi i të drejtave, në pajtim me standardet e përcaktuara nga KPT-ja (shih paragrafin nga 45 deri në 48 të këtij raporti).
- Të miratohet një Rregullore disiplinore, e cila do t'i precizojë procedurat disiplinore dhe të drejtat e të huajit, të cilat i shqiptohet një masë e tillë.

Në pajtim me nenin 132, parografi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjeter, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkua e në pajtim me ligj*”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), mirësisht ju lutemi të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.



Me nderime,  
Hilmi Jashari  
Avokat i Popullit